

BASHKIA TIRANË
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESI

Drejtuar: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “VAS Konstruksion” shpk &”4AM” shpk Rruga "Gjin Bue Shpata", hyrja 1, kati 5, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Demolimi dhe evadimi i mbetjeve ndërtimore”, per 9 (nëntë) pallate.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-81300-12-07-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Tender i Kufizuar” me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e perzgjedhur në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Udhëzimit Nr. 1, datë 13.02.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, pika 7.1; Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 35/1 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Neni 41.

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar: Sipas short-listing të pasqyruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Salillari” shpk &”Arb&Trans 2010” shpk;
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “VAS Konstruksion” shpk & “4 AM” shpk

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazen tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Salillari” shpk &”Arb&Trans 2010” shpk NUIS J62903125G & NUIS L02325001T

Oferta ekonomike = 37,027,680 (tridhjetë e shtatë milion e njëzetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 44,433,216 (dyzetë e katër milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë me TVSH.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “VAS Konstruksion” shpk & “4 AM” shpk NUIS L61322023P & NUIS K92005016L

Oferta ekonomike = 33,145,300 (tridhjetë e tre milion e njëqind e dyzetë e pesë mijë e treqind) lekë pa TVSH dhe 39,774,360 (tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë me TVSH

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Salillari” shpk &”Arb&Trans 2010” shpk NUIS J62903125G & NUIS L02325001T.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Oferta e paraqitur nga BOE si me mësipërm ekonomikë është identifikuar si oferte e pasuksesshme pasi referuar pikëzimit nuk arrin pikët maksimale.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e operatorëve ekonomikë “VAS Konstruksion” shpk & “4 AM” shpk se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me 100 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Përgjegjës, Bashkia Tiranë*, sigurimin e kontratës prej 15 % të vlerës së saj, siç parashikohet në Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 43, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 08 / 02 / 2021

Ankesa: Në fazën e parë të procedurës së prokurimit nuk ka pasur ankesa.